

V E N D I M
Nr. 111, datë 19.2.1998

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË LUFTËS KUNDËR AKTEVE
TERRORISTE DHE TRAFIKUT TË ARMËVE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Shërbimit të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve, si shërbim i specializuar, gjurmues-hetimor i policisë kriminale, për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të akteve terroriste dhe trafikut të armëve.

2. Shërbimi i luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve organizohet në:

a) sektorin e luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve në përbërje të Drejtorisë së Policisë Kriminale;

b) zyrat rajonale të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve pranë drejtorive të policisë në shkallë prefekturale.

3. Sektori i luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve në Drejtorinë e Policisë Kriminale ka në përbërje të tij zyrën e luftës kundër akteve terroriste dhe zyrën e luftës kundër trafikut të armëve.

Detyrat funksionale, kompetencat e sektorit dhe të zyrave rajonale përcaktohen me rregullore të veçantë të Ministrit të Brendshëm.

4. Zyrat rajonale të luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve janë në vartësi të drejtpërdrejtë të sektorit “S.K.A.T.E.T” në Drejtorinë e Policisë Kriminale dhe funksionojnë në përbërje të sektorit të policisë kriminale në drejtorinë e policisë në shkallë prefekturale.

5. Ministrinë dhe strukturat e tjera qendrore të administratës shtetërore që lidhen me problemet e luftës kundër akteve terroriste dhe trafikut të armëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të përcaktojnë me akte të përbashkëta format dhe mënyrat e bashkëveprimit të tyre.

6. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet përkatëse për limitin organik dhe mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi.

7. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano